



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 12:10

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin "Programi për infrastrukturën komunale V" (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Lefter Koka, Zef Shtjefni, Halit Valteri, Klajdi Qama dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Tatiana Nurçe, Ilir Beqaj dhe Kujtim Gjuzi.

Të ftuar:

Lindita Sotiri – Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Jovan Gjika – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ana Kekezi – Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ligor Tollsuku – specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Niko Peleshi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese Tregtisë dhe Mjedisit, datë 16.12.2019, ora 12:10.

Në këtë seancë kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”.

Relator është zoti Andrea Marto.

Fjala për relatorin dhe më pas për të ftuarit.

Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kemi të ftuar: zonjën Lindita Sotiri, zotin Jovan Gjika, drejtor dhe zonjën Ana Kekezi, drejtoreshë.

Zoti Marto, fjala për ju.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji në fjalë synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”. Programi për infrastrukturën komunale V synon të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime në bashkitë e përfshira në këtë projekt, që janë Bashkia e Lezhës, Bashkia e Fieri dhe Bashkia e Sarandës, të cilat kanë qenë pjesë e fazave të mëparshme dhe dy të programit dhe të bashkive Berat, Kuçovë, Kamëz dhe Lushnjë, të cilat kanë qenë pjesë e fazave të mëparshme, I, II, III dhe IV të projektit.

Programi për infrastrukturën lokale V vjen si nevojë e përmirësimit për të përmbyllur investimet e kryera në fazat e mëparshme të programit. Programi në vetvete do të implementohet në dy faza: faza e parë konsiston në planifikimin dhe specifikimin e investimeve nëpërmjet përditësimit dhe hartimit të studimit të fizibilitetit. Në këtë fazë shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve do të mbështeten institucionalisht, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e performancës për të arritur kriteret e programit të vendosura si kusht paraprak për procedurat me hapat e zbatimit të projektit. Pra, kjo është një risi që do të investohet në ato shoqëri, të cilat kanë performancë pozitive dhe që vlerësohen të tilla nga ekspertë të pavarur.

Faza e dytë: komisioni konsiston në zbatimin në terren të investimeve të planifikuara nëpërmjet analizës së detajuar të studimeve të fizibilitetit. Shërbimet kryesore që do të kryhen në këtë fazë, konsistojnë në hartimin e projektit të detajuar dhe teknik në përgatitjen e dokumentacionit të tenderimit të punimeve, si dhe në kryerjen dhe mbikëqyrjen në terren të punimeve gjatë zbatimit të projekteve.

Marrëveshja në fjalë parashikon dakordësinë e dy qeverive për t'i mundësuar Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga KfW-ja një kredi të butë me vlerë të përgjithshme deri në 80 milionë euro, një kontribut financiar për masa të nevojshme shoqëruese deri në vlerën 3 milionë euro për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur më sipër, si dhe kontribut financimi me vlerë të përgjithshme deri në 6 milionë euro, i cili do të përdoret kryesisht në projektet që kanë prioritet mjedisin.

Ky projekt është parashikuar në programin buxhetor 2019-2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në programin ujësjellës-kanalizime. Duke qenë se projekti është mjaft i rëndësishëm, do të ndikojë në bashki dhe në një popullsi të gjerë për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe në trajtimin e ujërave të ndotura, ftoj kolegët që ta votojmë unanimisht projektligjin.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

T'u japim fjalën përfaqësuesve të ministrisë për ndonjë shtesë, plotësim në prezantim, pa u zgjatur, dhe më pas le ta zhvillojmë diskutimin përmes pyetjeve.

Lindita Sotiri – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

Ajo që dua t'i shtoj nga prezantimi, në fakt shumë i detajuar, është se kjo kredi 80 milionë euro që shoqërohet edhe me një grant në investime, por edhe në asistencë teknike, ku kryesisht fokusohet në projektimin dhe në supervizionin e punimeve, vjen në kuadër të infrastrukturës bashkiake V, si një paketë më e madhe në vlerë financiare, e shoqëruar me grante nga Bashkimi Europian dhe nga qeveria zvicerane. Kjo është një nga mbështetjet më të mëdha nga institucionet financiare të huaja e ardhur në sektorin e ujit dhe vlera totale do të shkojë në 130 milionë euro.

Gjithashtu, është e rëndësishme të përmendim që qytetet, në të cilat është targetuar programi, përgjithësisht janë qytete që janë në vijim, ku do të mbyllen investime shumë të rëndësishme në fushën e ujësjellësit, por do të vijmë edhe me faza të tjera në fushën e kanalizimeve apo impianteve, siç është rasti i Beratit, i Kuçovës apo i Shkodrës, ku do të përfundohet cikli me realizimin e impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura. Gjithashtu, ajo që është e rëndësishme të përmendet është që vazhdohet me të njëjtën metodologji. Janë targetuar 11 qytete, por, pas mbarimit të fazës së parë, pra studimit të fizibiliteteve dhe vlerësimi nga audituesit e pavarur për arritjen e kushteve, me të cilat do të implementohet kredia, këto qytete do të vlerësohen si të realizueshme apo të kualifikueshme për të marrë vazhdimin e investimit.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Fjalën e kanë kërkuar zoti Bitri, zoti Jakimi dhe më pas zoti Nasufi.

Robert Bitri – Së pari, me sa për qind jepet kredia?

Së dyti, nga relatori dëgjova dhe për qytetin e Fierit, të cilën zonja drejtoreshë nuk e përmendi, sepse, me aq sa di, edhe Fieri është me një kredi gjermane për pjesën e trajtimit të rrjetit të brendshëm të qytetit, i cili ka përfunduar zhvillimin deri te depot, por ka filluar dhe do të fillojë rrjetin e brendshëm të qytetit të Fierit. Nuk e di përfshihet apo jo.

Së treti, nuk del e qartë rritja, nga 80 milionë, thoni në 130 milionë. Kjo është nga ecuria e punimeve, apo nga realizimi i objektivave dhe është e gatshme për t'u rivënë përsëri? Pra, si është kjo 50, sepse këtu thuhet 80 milionë euro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjashta me treshin janë brenda tetëdhjetëshes apo janë jashtë?

Sa është investim direkt në rrjet? Sa kredi është për mbrojtjen e mjedisit? Cila është eksperiencia e treguar nga investitorët? Sa është investimi direkt dhe sa është për pjesën ndihmëse.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Jakimi

Halil Jakimi - Përshëndetje!

Dua të di cilat janë bashkitë që përfshihen në këtë projekt, nëse i keni, dhe përzgjedhja e bashkive është një fazë e mbyllur, apo nëse keni përzgjedhur disa bashki, a mund të ndryshojnë? Pra, të shtohen zona të tjera rurale që u përkasin po bashkive të tjera.

Së dyti, është ajo që tha kolegu më parë: sa është pjesa e investimeve direkte në ujësjellës-kanalizime nga këto para?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Nasufi!

Fadil Nasufi – Dua të jem dyfish falënderues për këtë marrëveshjeje, pra 80 milionë euro nëpërmjet bankës së KfW-së për rrjetin e ujësjellës-kanalizimeve dhe për infrastrukturën bashkiake, pra edhe si përfaqësues i qytetit të Beratit që ka gati mbi 10 vjet që bashkëpunon me programet e KfW-së dhe ka realizuar 4 komponentët e parë dhe do të vazhdojë që të përfitojë edhe nga kjo marrëveshje.

Pyetjet e mia janë këto: me bashkitë përkatëse a janë nënshkruar marrëveshjet me KfW-në dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ekonomisë, si palë e qeverisë shqiptare? Konkretisht: a janë specifikuar investimet konkrete që ne të dimë të themi: që të rehabilitohet territori ku janë bërë kanalet e furnizimit me ujë të pijshëm të lagjeve, apo do të ketë

kanalizime të përpunimit të ujërave të zeza dhe çfarë përmban paketa e komponentit V të kësaj kredie?

Së dyti, në këndvështrimin tuaj, i kanë bashkitë kapacitetet institucionale për menaxhimin e kredisë? Pra, a kanë filluar të shlyejnë pjesë nga kredia që kanë përfituar nga komponentët e tjera? A kanë bashkitë qëndrueshmëri apo janë me borxhe, që marrin subvencione për probleme të menaxhimit të rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve?

Së treti, nga përvoja që unë kam nga bashkëpunimi me KfW-në, kur isha kryetar bashkie, kanë hartuar një plan biznesi që parashikon të gjithë komponentët ekonomikë të reduktimit të humbjeve, të uljes së trendit të punonjësve që janë jospecialistë të forcimi i kapaciteteve e me radhë, a vazhdojnë këto të jenë sipas standardeve që kërkon KfW-ja, apo vazhdojnë ujësjellësit të jenë vende qokash, ku konsumojnë vende pune, të cilat nuk japin rendiment dhe nuk sjellin produktivitet?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Shtjefni!

Zef Shtjefni – Në fakt, zoti kryetar, të gjitha pyetjet u bënë, por unë jam i fokusuar, sepse këtu paraqiten dy grupime bashkish sipas fazave, disa bashki janë të fazës së parë dhe e dytë disa bashki janë të fazës së tretë dhe e katërt. Dua të di: si janë menaxhuar fondet e kaluara? A është e kënaqur KfW-ja gjermane, pasi ka dhënë një kontribut të madh në Shqipëri, a janë të kënaqur me punën që kanë bërë, me shlyerjen e detyrimeve gjatë viteve?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zoti Konomi!

Ardit Konomi – A ka ndonjë të dhënë për *turnover-in* e ujësjellësve aktualë?

Niko Peleshi – Faleminderit!

Në qoftë se nuk keni pyetje të tjera, do t'ju lutem, zonja Sotiri, t'u përgjigjeni pyetjeve një për një!

Lindita Sotiri – Faleminderit!

Për sa i përket pyetjes së deputetit Bitri, përgjithësisht kredia ka qenë me normë interesi 1,2%, por specifikat do të vendosen gjatë negociatave, sepse këtu jemi për marrëveshjen qeveritare gjatë negociatave që do të bëhen me Ministrinë e Financave gjatë hartimit të fazës së marrëveshjes financiare.

Për sa i përket qytetit të Fierit, ka qenë pjesë e infrastrukturës bashkiake I dhe II, rikthehet në infrastrukturën bashkiake V për të përfunduar sistemin e ujësjellësit në zonën

urbane të qytetit dhe për të filluar një pjesë të qytetit për kanalizimet. Nëse do të duhen detajet teknike për zonën, unë në fund do t'ia jap fjalën edhe kolegut që është koordinatori i KfW-së, që i ndjek nga afër në mënyrë teknike projektet.

Për sa i përket asaj që shpreha në fillim të fjalës sime, totalit të vlerës së asaj që ne konsiderojmë infrastruktura bashkiake, totali i vlerës prej 130 milionë euro është ndarë në 80 milionë euro kredi, që janë investime kapitale, pra që do të jenë të fokusuara në investime direkte ujësjellës-kanalizime apo impiante të trajtimit të ujërave të ndotura, siç është rasti i Beratit apo Shkodrës. 3 milionë janë asistencë teknike, por, që, në fakt i shërbejnë projektit. Pra, nuk janë asistencë teknike e përgjithshme që kanë të bëjnë me hartimin e projektit dhe me supervizionin e projektit; 6 milionë që janë pjesë e kësaj marrëveshjeje që flasim, pra 89-shi janë investime direkte, por të kualifikuara në komponentë që justifikohen për mbrojtjen mjedisore. Pra, nuk mund të kalohen në ujësjellës direkt, por janë të specifikuara sipas trajtimit të çështjeve mjedisore, pra protokolleve dhe misionëve të vlerësimit që janë ndërmarr midis palëve. Ndërkohë, pjesa tjetër që përbën 130 milionëshin janë grante nga Bashkimi Europian dhe nga qeveria zvicerane, por, gjithsesi, grante të fokusuara në investime, pra joasistencë teknike. Përgjithësisht grantet e Bashkimit Europian kanë qenë të fokusuara në kanalizime dhe në ndërtimin e impianteve, ndërkohë që grantet zvicerane i kanë ardhur në ndihmë paketës totale për të ulur barrën e kredisë së shtetit shqiptar. Pra, nga ky total 130 milionë euro asistencë teknike është 3 milionë euro për hartimin e projekteve dhe për supervizionin. 130 milionëshin nuk e shikoni në total, pasi kjo marrëveshjeje ka fokus qeverinë Federale Gjermane, pra jo marrëveshjet me institucionet financiare të tjera që është Bashkimi Europian dhe SECO.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Pra, janë marrëveshje të tjera që kanë të njëjtin fokus, të njëjtën emërtesë brenda të njëjtit program, por për shkak të faktit që janë me financues të tjerë, vijnë në marrëveshje të tjera, pra janë parashikuar për vitin tjetër.

Për sa i përket pyetjes së deputetit tjetër: 11 bashkitë që janë targetuar, janë përzgjedhur në bazë të kriterëve të caktuara.

Së pari, ka qenë përfundimi i investimeve të këtyre që shikoni në relacion, që quhet faza e para, faza e dytë, faza e tretë dhe faza e katërt.

Për shembull, marrim Gjirokastrën. Ndërkohë që një pjesë e qytetit është mbuluar në fazën e parë dhe të dytë, në të tretën dhe në të katërt ne bëjmë furnizimin me ujë 24 orë në pjesën e sipërme dhe të dytë të qytetit.

Për sa u përket bashkive Berat dhe Kuçovë, duke qenë se ka përfunduar në pjesën e qytetit furnizimi me ujë, tani fokusi është në kanalizime, pra vijohet puna në qytetet që janë përzgjedhur, kryesisht janë ato që është punuar në fazat e para për të mbyllur ciklin e investimeve. Nuk mund të ndryshohen, sepse kanë qenë pjesë. Bisedimet për këtë marrëveshjeje, në mos gaboj, kanë nisur që në vitin 2016 dhe protokoli qeveritar është nënshkruar në vitin 2018. Ajo që mund të ndodhë, që, për fat të keq, ne shpresojmë të mos ndodhë, është që, nëse ndonjë prej ujësjellësve në angazhimet që ka marrë përsipër gjatë fazës së parë të projektit nuk arrin kushtet, pra nuk arrin atë që është performanca e pritshme, atëherë, për fat të keq, ai do të jetë i përjashtuar nga investimet kapitale.

Sigurisht, ne si ministri jemi duke bërë maksimumin, që, pavarësisht se është funksioni i bashkive të shtyjme maksimalisht që të jenë përfitues të këtyre investimeve, të cilat janë të domosdoshme për qytetet e tyre.

Për sa i përket pyetjes së zotit Nasufi: me bashkitë gjatë fazës së vlerësimit që ju e dini fare mirë, që është në faza të caktuara, që vjen delegacioni nga qeveria gjermane, të gjitha bashkitë kanë nënshkruar minutat e takimit në kuptimin e marrëveshjes ndërinstytucionale. Ato do të nënshkruhen në një fazë të dytë, për sa i përket infrastrukturës bashkiake V. Ndërkohë për sa i përket infrastrukturës bashkiake III, IV, I dhe II janë nënshkruar marrëveshjet përkatëse.

Për sa u përket kapaciteteve institucionale dhe qëndrueshmërisë së ujësjellësve dhe, rrjedhimisht, edhe kapaciteteve shlyese të bashkive dhe ujësjellësve përkatëse përgjithësisht vijmë nga një eksperiencë pozitive, ku disa prej shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, ku është maturuar kredia e parë, kanë filluar të shlyejnë detyrimet që kanë marrë përsipër. Gjithashtu, për këtë shërben edhe ajo që ne po e fusim si metodologji implementimi të investimeve edhe me investimet me buxhet shteti, vlen ai që është parakusht për vënien në jetë të investimeve të KfW-së. Pra, të sigurohemi që, në njëfarë mënyre ato hapa të bëjë në biznesplanet e shoqërive, pra në fazën e parë prej infrastrukturave bashkiake, nëse janë realizuar apo jo. Pra, a kemi arritur në shoqëri të qëndrueshme. Sigurisht, që shumë punë ngelet ende për t'u bërë. Në kuptimin makro përtej kredisë, unë nuk doja të detajohesha shumë, por, nëse është e nevojshme, sigurisht që mund të detajohemi. Ne kemi kontrata performance të lidhura me secilin kryetar bashki. Është viti i dytë që implementohet në mënyrë që të nxiten për t'i realizuar këta objektiva. Si ministri në buxhetin e shtetit kemi edhe një grant performance, ku nëpërmjet një skeme transparente të monitoruar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve është duke u implementuar dhe secila prej shoqërive nuk subvencionohet më

vetëm për mbulimin e kostos së energjisë elektrike dhe të klorit apo të elementeve të tjera të kostos operative, por ka një grant të dedikuar për ato që performojnë më mirë.

Për sa i përket pyetjes së deputetit Shtjefni, pak a shumë, iu përgjigja. Besoj se, përgjithësisht, fondet janë menaxhuar në mënyrë të mirë, të kënaqshme edhe nga partneri investues dhe kredidhënës që është KfW-ja. Për këtë janë fakt edhe vlerësimet që bëjnë ata nga auditues të pavarur, por, edhe fakti bashkëpunimi në investime është duke u rritur dhe është një investim i qëndrueshëm. A ka raste për të përmirësuar secila prej palëve?! Pa diskutim që po. Nëse kolegu Jovani i KfW-së mund të shtojë ndonjë prej rasteve, besoj se, me lejen tuaj, është i mirëpritur.

Për sa i përket pyetjes së deputetit Konomi për *turnover-in* aktual; sigurisht, ne i kemi shifrat. Unë nuk mund t’jua them për të evituar bërjen e ndonjë gabimi, por mund t’jua sjellim me shkrim në mënyrë të detajuar për secilën shoqëri të ujësjellës-kanalizimeve, me lejen tuaj, nëse keni mirëkuptimin.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Marto!

Andrea Marto – A ka ndonjë vlerësim ministria ose Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, sa nga këto ndërmarrje të planifikuara ose të programuara për të përfituar nga kredia, do të arrijnë të plotësohen kushtet për ta përfituar atë?

Niko Peleshi – Ka edhe një pyetje nga zoti Jakimi.

Halil Jakimi – Po i kthehem edhe një herë shqetësimit që ngrita më parë, ka ujësjellës, ku qeveria është fokusuar te pjesa e miratimit të ujësjellësve urbanë ose kryesisht te furnizimi me ujë për zonat urbane, por janë ujësjellësa ku është kryer faza e parë. Për shembull, në Bashkinë Bulqizë është një ujësjellës në njësinë administrative Gjoricë, ku në fazën e parë, në mos gaboj, është investuar rreth 1 milion euro dhe është investuar në vitin 2016. Domethënë, a bën pjesë ky projekt tek ata ujësjellës, që e kanë të investuar fazën e parë, por presin çeljen për fazën e dytë, pasi edhe ato investime që janë bërë po amortizohen, sepse ka 3 vjet që pritet dhe është një zonë me një ndikim shumë të madh prej 6 mijë banorësh, të cilët sot nuk gjejnë furnizimin me ujë. Pra, a ka ndonjë mundësi, nëse do të ketë tepriçë nga këto 11 bashki, që është parashikuar? Të lutem, nëse keni mundësi, a i lexoni se cilat bashki janë?

Lindita Sotiri – Faleminderit!

Për sa i përket pyetjes së deputetit Marto, është bërë një vlerësim për të gjitha qytetet, që do t’i përmend të gjitha që janë pjesë e infrastrukturës bashkiake V dhe deri tani rezultojnë të qëndrueshme në kuptimin e targeteve të vendosura për marrjen e kredisë.

Qytetet në të cilat është fokusuar infrastruktura bashkiake V janë: Shkodra, Lezha, Kamza, Elbasani, Lushnja, Berati, Kuçova, Fieri, Vlora, Gjirokastra dhe Saranda.

Për sa i përket Bulqizës, dhe pse janë këto qytete që përmenda në vazhdim të investimeve, kuptohet që i referohem faktit që janë me të njëjtin donator, pra me KfW-në. Bulqiza nuk ka qenë pjesë e këtij partneri zhvillimor dhe, si rrjedhim, fazës së dytë që ju i referoheni, ne e kemi të parashikuar në buxhetin e shtetit për Bashkinë e Bulqizës një investim, i cili do të fillojë të implementohet në vitin 2020.

Për sa u përket zonave rurale, në kuadrin e fokusit të kësaj marrëveshjeje, ministria me këta donatorë ka administruar zonat urbane, ndërkohë që zonat rurale me këtë partner zhvillimor kanë qenë të implementuara dhe vazhdojnë të jenë të implementuara për sa i përket fazës tjetër, ku përfshihet Bashkia e Himarës së bashku me të gjithë zonën dhe fshatrat turistike nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Ndërkohë që fokusi i ministrisë në zonat rurale, është nëpërmjet buxhetit të shtetit, i cili kuptohet me limitimet e tij. Ne si target kemi pasur realizimin me 24 orë uji të zonave bregdetare dhe të zonave urbane dhe një target me të cilin është adresuar buxheti në 3 vjetët e ardhshëm, është edhe bërja e mundur e reduktimit të humbjeve. Pra, të asaj që ne e teknikisht e quajmë ujë pa të ardhura. Pra, Bulqiza, pavarësisht se është në fazën e dytë, është adresuar me buxhetin e shtetit, por nuk është objekt i këtij donatori.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Faleminderit për të gjitha shpjegimet që dhatë dhe na bëtë një kthjellim të të gjitha investimeve dhe situatave në këto bashki, për të cilat KfW-ja gjermane dhe qeveria gjermane është impenjuar, dhe gjejmë rastin ta falënderojmë!

Pyetja ime ka të bëjë me një aspekt fare të shkurtër, fazën V, a arrijnë ta mbyllë një bashki apo më shumë se sa 1 plotësisht projektin që të mos jetë më në fazën VI, pra a jemi diku në këtë fazë?

Niko Peleshi – Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, u japim përgjigje pyetjes së zotit Pëllumbi dhe kalojmë në votim.

Jovan Gjika – Ashtu siç e shpjegoi kolegja, programi implementohet në disa faza: fillon me komponentë nga ai që është më e vështirë dhe ngre performancën e shoqërisë që është ujësjellësi. Tek ujësjellësi kemi probleme dhe aty krijojmë të ardhura dhe i bëjmë ndërmarrjet rentabël. Gjatë fazave të mëparshme kemi arritur që qytete, si Lezha të kenë 24 orë ujë, Fieri në pjesën e mbaruar të projektit ka 24 orë ujë dhe indirekt pjesa tjetër ka orare

më të mira furnizimi. Po kështu, kjo situatë ndodh në të gjitha qytetet, por në fazat e mëparshme...

Prandaj, qytetet janë në disa faza, sepse bëhen pjesë-pjesë, nuk mund të fusësh fonde, sepse nuk t'i pranon modeli financiar, pra fonde të menjëhershme në një qytet dhe të mbarosh në një qytet, pastaj të vazhdosh te të tjerat. Me fazën V ne mbarojmë ujësjellësat në shumicën e qyteteve që janë përfshirë. Gjirokastra mbaron 100%, Berati mbaron me fazën e tretë dhe të katërt 100%. Me këtë fazë në Berat arrijmë edhe kanalizimet në masën 80%. Nëse Gjirokastra do të përfitojë, atëherë do të bëjmë edhe impiant; në Shkodër, bashkë me fazën e mëparshme, arrijmë të optimizojmë ujësjellësin në maksimum e tij. Nuk e di, sepse ka shumë zona informale, nëse do të arrijmë t'i mbulojmë për efekt fondesh t'i grumbullojmë të gjitha ujërat e zeza të ndara, t'i transportojmë me kolektor dhe t'i trajtojmë me impiant. Pra, koncepti i programit është se ka disa faza për efekt të modelit financiar dhe kryesisht fillohet me ujësjellësin, pra mbulohet ujësjellësi, sigurohet furnizimi me ujë dhe më pas kalohet te çështjet mjedisore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lindita Sotiri – Po, është e vërtetë, nëse i referohemi termit bashki, në kuptimin territorial administrativ, asnjëra prej bashkive nuk mbyllet as në fazën V, sepse nuk ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jovan Gjika – Nëpërmjet kësaj faze në Fier përfundon ujësjellësi i qytetit.
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Punimet parashikohen të fillojnë në vitin 2021 dhe për 2 vjet parashikohet ndërtimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

2 vjet është afati i gjithë programit për zbatim, qytet më qytet. Ka edhe më shpejt, se në varësi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Në qoftë se nuk ka gjë tjetër për të shtuar, atëherë kalojmë në votim.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit të gjithëve!

Faleminderit edhe përfaqësuesve të ministrisë për të gjithë sqarimin e detajuar!